



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:210204
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06210276

C-I- 24-0021

Paditësi / Propozuesi : Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, Rr. Driton Hoxha nr. 55, Prishtinë

Kundër :

Të Paditurit / Kundërshtarit të sigurimit : 1) Agrokosova Holding SHPK, Sh, Suharekë
2) H H SHPK, Sh, Suharekë .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me kolegjin e specializuar gjyqtarin kryesues Hasim Sogojeva, dhe gjyqtarët anëtarë Asllan Krasniqi dhe Murat Hulaj, në lidhje me propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, në seancë vendimmarrëse dt. 25 shtator 2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar propozimi i propozuesit Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë me të cilën ka kërkuar, caktimin e masës së sigurimit, ashtu që Kundërshtarëve të sigurimit Agrokosova Holding shpk dhe H H shpk, t' ju ndalohet çfarëdo veprimi juridik – shitblerja bartja e pronës në personin e tretë lënia në hipotekë dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrin kadastral sipas përshkrimit në Aktvendimin më poshtë,

Aktvendimin, dt., për ndarje të ngastrave :

**P-, D , me sipërfaqe 37634, vendi i quajtur .dhe
P-, D , me sipërfaqe 5627, vendi i quajtur ..**

Sipas Aktvendimit, dt. për bartje :

**P- D, D , me sipërfaqe 1475, vendi i quajtur ...,
P- ..., D , me sipërfaqe 210, vendi i quajtur ..**

P- ..., D , me sipërfaqe 2080, vendi i quajtur ..
P- ..., D , me sipërfaqe 850, vendi i quajtur ..
P- ..., D , me sipërfaqe 790, vendi i quajtur ..
P- ..., D , me sipërfaqe 4503, vendi i quajtur ..

Rrethanat e Faktike

Më 25.07.2024, paditësit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në Prishtinë ka ushtruar padi dhe propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit për anulimin e Aktvendimit KE nr. 438/23, datë 20.12.2023, Marrëveshjes për ndërmjetësim Nd. Nr. 03/3, dt. 15.12.2023, Aktvendimit 11- 463-17684 -2024 për ndarje të ngastrave dhe Aktvendimit 11- 463-17684 për aprovim dhe bartje .

Në parashtresë të padisë ka theksuar se Bordi i Drejtorëve/AKP me Vendimin nr. ref. BD - 158/1, të datës 31 janar 2022, duke u bazuar në nenin 15.1, 31.3 dhe 31.4 të Ligjit për Agjencinë nr. 04/L-034, për shkak të mos përmbushjes së kushteve nga neni 6.2.1 dhe 6.2.2 i marrëveshjes së zorimit të dt. 27gushtë 2007, ka vendosur të tërheqë aksionet e Ndërmarrjes e Re „ Agrokosova Holding shpk ” .

Bazuar në Vendimin Ref BD – 158/2, dt. 31 janar 202, Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 6 dhe 15.2.5, të Ligjit për Agjencinë si dhe Rregullores për Administrim Direkt nr. 02/2020, ka vendosur që Ndërmarrja e Re Agrokosova Holding të vendoset në Administrim Direkt të AKP-së.

Agrokosova Holding SHPK dhe Q Qendra e Mobileve Italiane SHPK, kanë parashtruar padi për anulimin e Vendimeve të Bordit të drejtorëve të AKP-së, Ref BD -158/1, dhe nr. REF BD -158/2, të dt. 31.01.20022,

Me Aktvendimin e DHPGJS C- I- 22- 0001, dt. 04.04.2022, është refuzuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit të ushtruar nga Ndërmarrja Agrokosova Hollding SHPK dhe Q SHPK.

Me aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS AC- I- 22- 0227 , dt. 23.05.2022, është vendosur që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet Aktvendimi i shkallës së parë C- I- 22- 0001, dt. 04.04.2022, ashtu që është aprovuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit .

Më dt. 22.07.2024, paditësi AKP, ka pranuar përgjigjen e Drejtoratit për Shërbime Pronësore, Juridike, Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Suharekës lidhur me Aktvendimin 11- 463-17684-2024, që janë bërë ndryshime kadastrale të ngastrave të privatizuar nga Agrokosova Holding në vitin 2007, duke u bazuar në marrëveshje të Ndërmjetësimit Nr. 03/23, dt. 15.12.2023, të lidhura ndërmjet të paditurave H H SHPK dhe Agrokosova Holding SHPK të cilën marrëveshje e ka aprovuar Gjykata Komerciale e Kosovës me Aktvendimin KE nr. 438/23, më dt. 20.12.2023.

Ka theksuar se është duke u zhvilluar procedura gjyqësore në këtë gjykatë sipas padisë C- I- 22- 0001, kundër Vendimit të AKP-së, BD 158/1, dt. 31.01.202, për shkak të mos përmbushjes së zotimeve të kontratës dt., kurse në këtë padi është si kërkesë, anulimi i Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës nr. 438/23, dt. 20.12.2023, për marrëveshjen e ndërmjetësimit Nd. 03/23, dt. 15.12.2023, të lidhura ndërmjet të paditurave .

Lidhur me anulimin e Aktvendimit të KE nr. 438/23, dt. 20.12.2023, Agjencia vlerëson se Gjykata Komerciale nuk ka pasur juridiksion të vendos për pranimin e marrëveshjes për ndërmjetësim, pasi kjo çështje është në juridiksion të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Lidhur me anulimin e Aktvendimit 11- 463-17684- 2024, dhe Aktvendimin 11- 563-17684, Drejtoria e Kadastrit në Suharekë nuk ka marrë ndonjë mendim apo pëlqim paraprak nga ana e AKP-së, lidhur me lejimin e ndryshimeve në rastin konkret sipas nenit 85.1 të Ligjit 05/L-031 , për procedurën administrative .

Lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit Nd. Nr. 03/23, dt. 15.12.2023, objekti i marrëveshjes ka të bëjë për ngastrat të cilat janë objekt i kontestit dhe lidhur me rastin nuk është vendosur akoma , por është vendosur vetëm me masën e sigurimit .

Me marrëveshje të ndërmjetësimit palët nuk kanë mundur të disponojnë lirisht sipas nenit 3 paragrafi 3, të LPK-së, dhe askush nuk mund të bartë të drejta më shumë se që ka vetë.

Në lidhje me propozimin për caktimin e masës së sigurimit AKP vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit, për faktin se neni 66.1 i Ligjit nr. 06/L-086, ka paraparë se kur mund të caktohet masa e sigurimit .

AKP-ja, me prova ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës , sikundër edhe të rrezikut që pa caktimin e masës do të pësoj dëm të pa riparueshëm.

AKP-ja, vlerëson se provat lidhur faktet e prezantuara me këtë propozim e bëjnë të besueshme kërkesën dhe rrezikun .

Ka propozuar të Caktohet masa e sigurimit dhe kundërshtarëve të sigurimit t' ju ndalohej çfarëdo veprimi juridik – shitblerja bartja e pronës në personin e tretë lënia në hipotekë dhe çfarëdo ndryshimi ndryshimi në regjistrin kadastral sipas përshkrimit në Aktvendimin më poshtë :

Aktvendimin, dt., për ndarje të ngastrave :

P- ..., D , me sipërfaqe 37634, vendi i quajtur A e Udhe

P- ..., D , me sipërfaqe 5627, vendi i quajtur A e U

Sipas Aktvendimit, dt. për bartje :

P- ...,D , me sipërfaqe 1475, vendi i quajtur ...

P- ..., D , me sipërfaqe 210, vendi i quajtur ..

P- ..., D , me sipërfaqe 2080, vendi i quajtur ..

P- ..., D , me sipërfaqe 850, vendi i quajtur ..

P- ..., D , me sipërfaqe 790, vendi i quajtur ..

P- ..., D , me sipërfaqe 4503, vendi i quajtur ..

Ka bashkangjitur provat :

- Njoftimi i AKP-së, për paditësin Agrokosova SHPK dhe Q ShPK, dt. 31.01.2022, për vendimin e Bordit për tërheqje të aksioneve ,
- Vendimi nr. Ref BD -158/1, dt. 31.01.2022, i Bordit të Drejtorëve,
- Vendimi Ref BD 158/2, dt. 31.01.2022, me të cilin Ndërmarrja Agrokosova Holding vendoset në administrim direkt,
- Aktvendim i Kolegjit të DHPGJS AC- I- 22- 0227 me të cilin është caktuar masa e sigurimit ,
- Shkresa e Komunës së Suharekës – Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike , Gjeodezi dhe Kadastër , për AKP-në dt. 15.07.2024,
- Kërkesa dt. 18.03.2024, e ushtruar nga H SHPK , A G ,
- Marrëveshja për ndërmjetësim e lidhur ndërmjet H H SHPK dhe Agrokosova SHPK, dt. 15.12.2023,
- Aktvendimi KE 438/23, dt. 20.12.2023, i Gjykatës Komerciale në Prishtinë,
- Aktvendimi i Komunës së Suharekës, Zyra Kadastrale , 11- 463-17684-2024, dt. 02.04.2024,
- Aktvendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, dt. 22.05.2024, nr. 03, 677/24,
- Aktvendimi i Komunës së Suharekës, Zyra për Kadastër 11- 463/17684-2024, , dt. 28.05.2024,
- Aktvendimi i lëshuar nga Komuna e Suharekës, Zyra për Kadastër 11- 463-17684, dt. 29.05.2024,
- Kërkesë për regjistrimin e drejtës pronësore , e pa lexuar,
- Kontratë mbi shitblerjen e lidhur te notarija A M M, LRP, Ref, dt., e lidhur ndërmjet H H SHPK dhe I T SHPK , ku si objekt i palujatshmerisë është ngastra ., me sipërfaqe 1.3000m2, ZK Gj.
- Aktvendimi i Komunës së Suharekës , Zyra për Kadastër, nr. 11- 463- 34475- 2024,
- Certifikata e pronës, në emër I T , dt., për ngastrën nr., me sipërfaqe 13000m2,
- Certifikata e pronës, në emër H H , dt..

Më dt. 26.07.2024, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- I- 24- 0021, për paditësin – propozuesin dhe të paditurit – kundërshtaret e sigurimit .

Propozuesit ju është kërkuar të dorëzojë ekspertizë gjeodezike në afatin prej 7 dite për identifikim të pronave lëndore si në propozim.

Të paditurve ju është kërkuar të japin përgjigje në padi dhe në propozim për masë të sigurimit.

Të paditurve ju është urdhëruar të përmbahen nga çfarëdo veprimi, derisa gjykata të vendos për masë të sigurimit .

Më dt. 01.08.2024, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtresën me të cilën ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të dorëzohet ekspertiza gjeodezike, si provë .

Më dt. 09.08.2024, i padituri i parë Agrokosova Holding Shpk Suharekë të përfaqësuar nga H T Drejtor menaxhues , ka dorëzuar parashtresën e përgjigjes në padi dhe në propozim të masës së sigurimit.

Në parashtrësë është deklaruar se nuk është kontestues fakti se AKP-ja, Bordi Drejtues me nr. Ref BD 158/1, dt. 31.01.2022, ka marrë aktvendim për tërheqje të aksioneve ndaj Ndërmarrjes së Re Agrokosova Holding Shpk, Suharekë dhe kthimi i aksioneve nën administrimin e AKP-së.

Mbi bazën e këtij Vendimi AKP-ja kishte kërkuar në Agjencinë Për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), ndërrimin e Aksioneve të Ndërmarrjes Agrokosova Holding SHPK , ndërsa më dt. 03.02.202, ARBK kishte përgatitur njoftimin për Agrokosova Holding SHPK duke i njoftuar se ka vepruar sipas kërkesës së AKP-së, për kthimin e aksioneve për Ndërmarrjen e Re Agrokosova Holding SHPK ,

Më dt. 03.02.2022, rreth orës 11, në Suharekë, në Ndërmarrje Agrokosova Holding Shpk, ka ardhur deri te ndërhyrja e policisë dhe me forcë të policisë, pronari i kësaj ndërmarrje është deposeduar nga sendet e palujatshme dhe të luajtshme .

Në të njëjtën ditë ka prezantuar një person si zyrtar i AKP-së, ashtu që i njëjti ka kërkuar nga pronari H T që të dorëzojë Ndërmarrjen vullnetarisht , pa u sqaruar kujt ti bëhet dorëzimi dhe si të bëhet dorëzimi .

Pas deklarimit të përfaqësuesit të Ndërmarrjes se refuzon dorëzimin vullnetar, dhe se është si kontestuese e drejta për ndërhyrje dhe baza juridike e dorëzimit, Udhëheqësi i Njësisë Policore, kishte urdhëruar largimin me forcë të përfaqësuesit të Ndërmarrjes dhe personave të tjerë .

Me rastin e largimit nga posedimi Pronarit të Ndërmarrjes nuk ju dha asnjë letër , dhe fati i pasurisë së tijë më nuk ka trajtim ligjor por varej nga vullneti i veprimeve të kundërligjshme të AKP-së, duke përfshirë edhe partneret e kësaj Ndërmarrje.

Më dt. 24.02.2024, Ndërmarrja Agrokosova Holding SHPK, ka ushtruar padi kundër të paditurës, për anulimin e Vendimeve të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe propozim për masë të sigurimit ashtu që Kompleksi i Ndërmarrjes ti kthehet në dorëzim paditësit.

Më dt. 04.04.2022, DHPGJS , shkalla e parë kishte marrë Aktvendimit C- I- 22- 0001, me të cilin e kishte refuzuar propozimin e paditësit për masë të sigurimit.

Më dt. 23.05.2022, Kolegji i Apelit ka nxjerr Aktvendim AC -1-22-0027, me të cilin ka ndryshuar aktvendimit e shkallës së parë dt. 04.04.2022, dhe është aprovuar masa e sigurimit , ashtu që Kompleksi i Ndërmarrjes Agrokosova Holding Shpk, me pronën e patundshme dhe të tundshme ju kthehet paditësit sipas gjendjes së dt. 31.01.2022.

Obligohet AKP-ja të lejojë kthimin e të gjithë punëtorëve në punë dhe të lejoj regjistrimin Ndërmarrjes në ARBK në emër të paditësve, paditësit janë obliguar të deponojnë shumën 10,000€ .

Në lidhje me përmbushje të zotimeve që ka qenë si shkasë tërheqja e aksioneve nga AKP me aktvendim, është deklaruar se jemi sqaruar në padi , sikundër kjo çështje është sqaruar edhe në Aktvendim të Kolegjit të Apelit të DHPGJS .

Me kthimin e pronës paditësve ju është kthyer legjitimiteti i plotë si pronarë i ndërmarrjes për të vepruar si pronarë.

Ka theksuar se gjatë periudhës kohore sa është deposeduar pronari i Ndërmarrjes, të njëjtit ju është shkaktuar dëm në sende të luajtshme dhe të paluajtshme, pastaj si pasojë e obligimeve të pa përmbushura ndaj kreditorëve dhe palëve të treta, ndërsa pas kthimit të aseteve ishte përball me dhjetra kërkesa kreditore përmes procedurave të përbarimit dhe padive civile.

Në lidhje me kërkesën e kreditorit H H SHPK, ndaj Ndërmarrjes Agrokosova është deklaruar se Ndërmarrja H H kishte ushtruar padi civile në Gjykatën Komerciale në Prishtinë më dt. 06.06.2023, me të cilin kishte kërkuar përmbushjen e detyrimit kontraktor , të përshkruar në padi, dhe në procedurë gjyqësore nuk ishte e mundur të kundërshtohet me asnjë provë ky detyrim dhe në pamundësi të kësaj Gjykata Komerciale ka lejuar të shkohet në procedurë të ndërmjetësimit , ku është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit, pas nxjerrjes së ekspertizës financiare dhe pas kësaj gjykata e ka lejuar marrëveshjen e ndërmjetësimit EK 438/23, numri i lendes Nd 03/23, dt. 26.10.2023.

Në lidhje me padinë ka theksuar se padia e AKP-së e ushtruar ndaj të paditura nuk është e lejuar me arsyetim se AKP-së, i mungon legjitimiteti për të ushtruar padi për anulimin e aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë KE 438/23, dt. 20.12.2023, marrëveshjes së ndërmjetësimit Nd. 03/23, dt. 15.11.2023, dhe aktvendimeve kadastrale si në padi.

Mungesa e legjitimitetit konsiston në faktin se prona lëndore që ishte objekt i marrëveshjes së ndërmjetësimit evidentohet në emër të Ndërmarrjes Agrokosova Holding, pronarëve të kësaj ndërmarrje.

Në lidhje me propozimin për caktimin e masës së sigurimi, të njëjtin e ka kundërshtuar me pretendim se propozimi është i palejuar me vetë faktin se padia është e palejuar . Propozuesi nuk e ka bërë të besueshme kërkesën që është kritere për caktimin e masës së sigurimit . AKP-ja, po silltet sikur Ndërmarrja Agrokosova Holding SHPK është ndërmarrje shoqërore dhe sikur e njëjta është nën administrimin e saj . Lista poseduese dëshmon se pronat janë në emër të vetëm të Agrokosova Holding mbi bazën e regjistrimit në ARBK gjegjësisht me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. AKP përveç kësaj nuk ka ofruar prova materiale që e bëjnë të besueshme kërkesën, pastaj pretendimet janë shumë konfuz, në mënyrë shablonike dhe të pa argumentuar . Në rastin konkret kërkesa kreditore e të paditurit të dytë ndaj të paditurit të parë, po të mos ishte arritur në procedurë të ndërmjetësimit, të gjitha llogaria bankare të paditurit të parë do të ishte mbyllur dhe dukshëm do të ishte vështirësuar aktiviteti biznesor. Qëllimi i propozimit të masë së sigurimit është të bllokohet veprimtaria e të paditurit të parë, dhe të vihet në pozitë të falimentimit, përveç dëmeve materiale që ju janë shkaktuar gjatë periudhës kohore kur ju janë marrë asetet të paditurit të parë .

Ka kërkuar të hedhet si e palejuar propozimi ose të refuzohet për caktimin e masës së sigurimit.

Ka bashkangjitur, përveç provave të bashkangjitura nga paditësit /propozuesit edhe :

- Padinë e paditësit Agrokosova, dhe Q, kundër të paditurit AKP , për anulimin e Vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, ref. BD 158/1 dhe 158/2, dt. 22.02.2022, NË DHPGJS

për identifikim të pronave është deklaruar se nuk ka asgjë kontestuese sa i përket identifikimit të ngastrave e të cilat janë bartur tek personat e tretë , dëshmitë e ofruara nga Komuna e Suharekës është mjaftueshëm për identifikim të pronave objekt kontesti .

Ka kërkuar të aprovohet propozimi .

Më dt. 13. 08.2024, i padituri i parë – kundërshtari i sigurimit dorëzoj parashtresën si plotësim i përgjigjes në padi dhe propozim për masë të sigurimit ashtu që është deklaruar : se marrëveshja e zotimeve jo vetëm që është mbushur në tërësi por ajo është tejkualuar :

Më tej ka theksuar se është paguar në tërësi çmimi kontraktues nga Q SHKP dhe Gruppo V F në shumën 4, 175.999€.

Sa i përket zotimeve për investime kapitale , kjo marrëveshje ka paraparë investime kapitale në vlerë prej 6,600.000€, në veprimtari dhe objekte gjatë periudhës së zotimit, sikundër edhe punësimin së paku 172 punëtorëve me orar të plotë të punës, gjashtë muaj pas datës së marrëveshjes.

Me marrëveshje sipas nenit 9 .5 është paraparë ,, Për zgjidhjen e kontesteve palët duhet të veprojnë në përputhje me obligimet e tyre sipas Marrëveshjes duke mos paragjykuar përshtatjen përfundimtare në pajtim me vendimin e paraqitur në ndonjë rast arbitrazh ose gjykatë për zgjidhje të kontestit ”.

Lidhur me investimet e bëra në Ndërmarrjen Agrokosova Holding SHPK, ishte zhvilluar një kontest civil para Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, ndërmjet aksionarëve Ndërmarrja Agrokosova Holding dhe grupo V F me seli në Itali në cilësinë e paditësit kundër të paditurit Q me seli në Sh Suharekë për vërtetimin e kuotave të aksioneve të ndërmarrjes së lartë cekur . Kjo gjykatë kishte caktuar një ekspertizë me ekspertit dr V I më dt. 04.07.2017, dhe sipas ekspertit investimet e shoqërisë Agrokosova për periudhën e vitit 2008 deri në vitin 2017, ishte 27, 758, 754.12 €, - 100% investime Qendra e Mobileve Italiane Q SHPK, në shumë 19, 890.831.59€, dhe Gruppo V F s.pa, në shumë 5,867.982.53€.

Po ashtu është deklaruar edhe sa i përket punësimeve në Ndërmarrje.

Me këtë parashtresë ka bashkangjitur provat me dosje duke potencuar se këto prova janë dorëzuar edhe te rasti tjetër që është në gjykatë .

Kjo parashtresë të paditurit të parë, me dosje ju është dorëzuar AKP-së, më dt. 11.09.2024.

AKP –ja, nuk është deklaruar në këtë pretendime të kundërshtarit të sigurimit Agrokosova Holding SHPK .

Arsyetimi ligjor

Propozimi për caktimin e masës së sigurimit refuzohet.

Me dispozitën e nenit 61, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-086 rregullon „ Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t’i referohet asaj kërkesë/ padie ”.

Gjykata bazuar në provat e ofruara nga palët ndërgjyqës ka konstatuar këtë gjendje faktike :

Me Aktvendimin e Bordit të Drejtoreshave të AKP-së, BD 158/1, më dt. 31.01.2022, është vërtetuar fakti se të paditurve ju janë tërhequr aksionet e Ndërmarrjes së RE Agrokosova Holding SHPK Suharekë dhe është obliguar menaxhmenti i AKP_së, që të kërkojë nga blerësi aksionari Q SHPK dhe Gruppo V s pa, Ndërmarrjes së Re Agrokosova që të kthej mjetet e shpronësimit të cilat iu janë paguar nga Qeveria e Kosovës për shpronësimin e disa pronave të ndërmarrjes për nevojat e autostradës dhe është obliguar menaxhmenti i Agjencisë që të zbatojë këtë vendim bazuar në ligjin për AKP dhe ligje të tjera Vendimi hynë në fuqi në ditën e aprovimit. Kundër Vendimit është lejuar padia pran DHPGJS .

Në arsyetim të vendimit është theksuar se blerësi ka përmbushur zotimet 85.79%, të zotimeve për investime afatgjate gjatë periudhës 2007 deri në vitin 2017, janë investuar 7,378.005.02€, ndërsa është dashur të investohen 8,600.00.00€. ndërsa sa i përket punësimeve ka qenë e parapara të punësohen 3.075punëtor , ndërsa janë punësuar 759 punëtorë .

Përveç kësaj në lidhje me shpronësimet e disa ngastrave për të mirën publike -ndërtimin e autostradës Ndërmarrjes së Re Agrokosova nga Qeveria e Kosovës theksohet se blerësi ka marrë shumën prej 630,000.00€ mjete këto që janë transferuar në llogari bankare të Q në Teb Bankë që e ka dëmtuar- zbritur pasurimin e Ndërmarrjes së Re Agrokosova që do të kërkohej edhe kthimi i këtyre mjeteve .

Me Vendimin BD 158/2, të AKP-së, dt. 31.01.2022, Ndërmarrja e Re Agrokosova Holding është vendosur nën administrim direkt të AKP-së.

Më dt. 31 01 2022, AKP-ja ju ka drejtuar me shkresë Q H T dhe GruppoV F spa, duke i njoftuar lidhur me Vendimet e Bordit të Drejtoreshave të AKP-së dhe ju është kërkuar të liron Ndërmarrjen më së largu deri më dt. 03.02.2022, në ora 11h.

Më dt. 03.02.2024, është bërë lirimi i pronës dhe Kompleksi Agrokosova është marrën në posedim nga AKP-ja .

Me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS AC – I-22- 0227, dt. 23.05.2022, është ndryshuar Aktvendimi i shkallës së parë C- I- 22- 001, dt. 04.04.2022 dhe është aprovuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit ashtu që Kompleksi i Ndërmarrjes Agrokosova Holding shpk me pronën e patundshme dhe të tundshme , në prezencën e palëve dhe të procesverbalit për dorëzimin e sendeve u kthehet paditësve sipas gjendjes para datës 31.01.2022. Është obliguar AKP-ja, të lejoj kthimin e të gjithë punëtorëve në punë dhe të lejoj ri regjistrimin e ndërmarrjes

Agrokosova Holding SHPK në regjistrin e ARBK-së, në emër të paditësve para datës 31.01.2022. Kjo masë e sigurimit mbetet në fuqi derisa të vendoset me Aktgjykim përfundimtar të DHPGJS, mbi meritat e padisë. Obligohen paditësit në afat prej 5 ditëve në emër të deponitës të deponojnë shumën 10.000.00€, për kompensim të dëmit eventual të paditurit për shkak të masës së sigurimit.

Është vërtetuar fakti se Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike , Gjeodezi dhe Kadastër me shkresë dt. 15.07.2024, drejtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë është përgjigjur në parashtrësë të AKP-së dt. 09.07.2024, sipas të cilës Zyra e Kadastrës në Suharekë nuk ka pasur asnjë shkresë nga AKP me anë të cilës kjo e fundit ka kërkuar apo njoftuar për ndonjë masë të sigurimit apo për pezullim procedure lidhur me statusin juridike të pronave të evidentuara me të drejtën e qiramarrjes për 99 vjet në emër të subjektit Agrokosova Holding SHPK. Në parashtrësë është deklaruar se ka pasur kërkesë nga Ndërmarrja H H SHPK , për ndarje të ngastrave dhe bartje të drejtës në qiramarrje për 99 vite të pronave të evidentuara në emër të subjektit Agrokosova Holding SHPK. Kërkesës ju është bashkangjitur elaborati i matjeve , marrëveshja e ndërmjetësimit EK 438/23, Nd. 03/23, dt. 15.12.2023, Aktvendimi i Gjykatës Komerciale për aprovimin e marrëveshjes për ndërmjetës.

Në parashtrësë është deklaruar se ZKK në Suharekë e ka refuzuar kërkesën e parashtruesit H H, por Agjencia Kadastrale Kosovës ka aprovuar ankesën e parashtruesit dhe lënden e ka kthyer në rishqyrtim. Në procedurë të rishqyrtimit ZKK e Suharekës ka aprovuar kërkesën më dt. 28.05.2024. Me këtë shkresë AKP-së ju janë dorëzuar të gjitha provat .

Sipas marrëveshjes së ndërmjetësimit që është aprovuar nga Gjykata Komerciale të Kosovës në Prishtinë që është arritur ndërmjet të paditurave- kundërshtarëve të sigurimit, ndërmjet këtyre palëve ka ekzistuar një kontratë për cedimin të lidhur më dt. 03.11.2022, dhe nga ky raport kontraktor Agrokosova ka pasur një detyrim monetarë në shumën 542,282.00€, dhe për shkak të këtij detyrimi ka lindur kontesti civil në Gjykatën Komerciale. Pasi rasti është referuar në procedurë të ndërmjetësimit nga Gjykata, palët para ndërmjetësuesit kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësimit ashtu që detyrimi i shumës 542,282.00€, është kompensuar me palujatshmeri duke ja transferuar për 99 vjet kreditorit H H në Suharekë pronat si në vijmë :

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK Suharekë me sipërfaqe 158,163m², nga sipërfaqja e tërësishme 300,817m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK Suharekë me sipërfaqe 31396m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK L. me sipërfaqe 254.140m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK L.me sipërfaqe 5,909m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK Gj., me sipërfaqe 7,000m², nga sipërfaqja e tërësishme 237,707 m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK Gj., me sipërfaqe 13,000m² nga sipërfaqja e tërësishme 274,981m²,

Pjesën e ngastrës nr. P.ZK D, me sipërfaqe 5,627m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK D me sipërfaqe 210m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK D me sipërfaqe 2,080m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK D, me sipërfaqe 850m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK D, me sipërfaqe 790m²,

Pjesën e ngastrës nr. P.ZK S, me sipërfaqe 28,448 m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK S. me sipërfaqe 720m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK S. me sipërfaqe 210m²,

Pjesën e ngastrës nr. P., ZK S me sipërfaqe 7027m².

Sipas marrëveshjes vlera e tërësishme e ngastrave kadastrale është në shumën 620,000.00€, dhe diferenca e vlerës së ngastrave dhe e borxhit objekt kërkese, është në shumën 77,718€, të cilën shuma H H, ja ka paguar Agrokosova SHPK .

Këto prona në bazë të certifikatës së pronës janë bartur në emër të H H SHPK Suharekë , fshati Sh .

Gjykata vlerëson se pas konstatimit të kësaj gjendje faktike, dhe juridike përveç provave si Vendimit të Bordit të Drejtorëve Ref 158/1 dt.31.01.2022, me të cilin ju janë tërhequr aksionet Ndërmarrjes së Re Agrokosova Holding SHPK dhe Vendimit Ref 158/2 me të cilin është vendosur që kjo ndërmarrje të jetë nën administrimin direkt të AKP-së, ka dorëzuar edhe Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS AC- I- 22- 0277, dt. 23.05.2022, me të cilin është caktuar masa e sigurimit dhe të paditurit/ paditësit AKP ju është kërkuar të kthej në posedim Kompleksin Agrokosova SHPK si me pronë të patundshme ashtu edhe me pronë të tundshme, paditësit Agrokosova shpk. AKP në rastin konkret nuk ka dorëzuar kontratën e transformimit të pronës te privatizuesi, pastaj dëshminë- raportin e auditorit me të cilin do të konstatohej cilat kanë qenë obligimet e marra nga privatizuesi për zotime për investime kapitale dhe me zotime për punësim, nuk ka dorëzuar as ekspertizë gjeodezike edhe pse ka ekspertë të vet të gjeodezisë për identifikon e pronave kontestuese, ose ndonjë njoftim para dt. 09.07.2024, te Zyra e Kadastrit në Komunën e Suharekës. Gjithashtu paditësi / propozuesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi pasi ka marrë Aktvendimin e Gjykatës për masën e sigurimit me të cilin do të kufizoheshin veprimet juridike të paditurit / Kundërshtarit të Sigurimit në raporte kontraktore me persona të tretë.

Gjykata vlerëson që pas kthimit të aseteve te Ndërmarrja Agrokosova Holding SHPK, atij ju janë kthyer edhe të drejtat dhe përgjegjësit si person juridike të vepron në raport me persona të tjerë pra të krijoj në raporte kontraktore, pavarisht nga fakti se është iniciuar kontesti në procedurë tjetër gjyqësore lidhur me ligjshmërinë e Vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së , për kthimin e aksioneve nga privatizuesi te AKP-ja dhe vendosja në administrim të Ndërmarrjes.

Gjykata vlerëson se për caktimin e masës së sigurimit janë të nevojshme të plotësohen dy kushte ligjore dhe atë :

- Propozuesi i masës së sigurimit, duhet të jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive dhe
- Propozuesi duhet të jep prova, që pa caktimin e masës së sigurimit do të ketë dëme të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm, e që sipas kësaj dispozite dëmi i pa riparueshëm është vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar .

Gjykata vlerëson se sipas nenit 31.5 të Ligjit nr. 06/L 086, pala e cila e pohon ekzistimin e një fakti, ajo është e obliguar të paraqes prova fizike dhe /ose dëshmuere për mbështetjen e atij pohimi.

Në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit, me provat e dorëzuara deri në këtë fazë procedurës nuk ka argumentuar pretendimin e tij sa i përket ekzistimit të drejtës subjektive në kërkesën pronësore, që vërteton se Kundërshtari i Sigurimit nuk mund të hyjë në raporte kontraktore me persona të tjerë dhe nga obligimet e marra kontraktore t' ju kufizohet të disponojë me pronat objekt kontesti, nuk ka asnjë ndalesë të regjistruar në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP, për marreje të aksioneve i cili vendim është kontestues dhe për të njëjtin është duke u zhvilluar kontesti sa i përket ligjshmërisë së tij .

Sa i përket rrezikut që pa caktimin e masës së sigurimit palës do ti shkaktohet dëmi i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm, në rastin konkret gjykata vlerëson se dëmi veç është shkaktuar, pasi Kundërshtari i sigurimit Agrokosova Holding SHPK në bazë të raportit të kontratës për cëdim me Kundërshtarin e Sigurimit H H SHPK me marrëveshje të ndërmjetësimit në përmbushje të borxhit si kompensim ja ka bartë të drejtën e qiramarrjes për 99 vite ngastrat lëndore, që dt. 20.12.2023, me aktvendimi është pranuar marrëveshja nga Gjykata Komerciale në Prishtinë siç janë identifikuar në marrëveshje të ndërmjetësimit .

Gjykata me rastin e vendosjes për masë të sigurimit, pa paragjykuar përfundimin e kësaj çështje juridike në lidhje me kërkesëpadinë, dhe pa paragjykuar juridiksionin e Dhomës së Posaçme në lidhje me anulimin e Aktvendimeve të Zyrës Komunale të Kadastrit të Komunës së Suharekës të nxjerra në procedurë administrative apo të Aktvendimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, sikundër edhe në kërkesën për anulimin e marrëveshjes për ndërmjetësim, se kundërshtaret e sigurimit a' kanë vepruar me mirëbesimin apo me keqbesim, si në raportin kontrktual ashtu në marrëveshje të ndërmjetësimit, kur të njëjtit e dinë se ekziston një kontest për ligjshmërinë e Vendimit të AKP-së për kthimin e aksioneve të njëjtit, këto rrethana do të vlerësohen kur do të vendoset për padinë e paditësit.

Gjykata vlerëson se meqenëse deri në këtë fazë të procedurës nuk janë argumentuar pretendimet e propozuesit të masës së sigurimit për të bërë të besueshme kërkesën, ndërsa rreziku veçë është shkaktuar dhe propozimi për masë është bërë pa efekt, tani për tani propozimi për masë të sigurimit nuk mund të pranohet , sipas nenit 61 të Ligjit nr. 06/L-086, dhe për këtë arsye edhe është refuzuar masa e sigurimit .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar kryesues

Asllan Krasniqi, Gjyqtar

Murat Hulaj, Gjyqtar